



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS
DHE ENERGJISË

Nr. 4258/prot.
3

Tiranë, më 27.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1696, datë 01.04.2014.

SHOQËRISË "KROMEX" SH.P.K
Sheshi "Skënderbej", Pallati i Kulturës, Kati i II-të, Zyra 1 A, Tiranë.

Për dijeni: SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR
Rruga "Myslim Keta", Ish Instituti Ushtarak Shqiptarë, Tiranë.

Shoqëria "Kromex" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të kërkim- zbulimit nr.1696, datë 01.04.2014, të dhënë për mineral kromi, në objektin "Pishkash", Bashkia Prenjas, Qarku Elbasan.

Nga shoqëria juaj, me shkresën nr.26, datë 01.06.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.4258, datë 01.06.2017, është kërkuar shndërrimi i kësaj leje kërkim - zbulimi në leje shfrytëzimi.

Kërkesën tuaj e dërguam në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, bazuar në nenin 43, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, si strukturë përgjegjëse që monitoron programin e miratuar në lidhje me vëllimin e punimeve dhe vlerën e investimeve, për një leje minerare kërkim - zbulimi.

Në përgjigje të shkresës sonë, ku kërkohej propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar në lidhje me kërkesën tuaj, SHGJSH, me shkresën e saj nr.1454/1, datë 02.08.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI), me nr.4258/2, datë 07.08.2017, ka vënë në dukje të gjitha shkeljet ligjore që janë vërejtur në periudhën për të cilën ka qenë dhënë leja e kërkim - zbulimit në fjalë. Bazuar mbi sa më sipër, ju njoftojmë se nuk plotësohen kriteret e përcaktuara në pikën nr. 3, të nenit 12, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, që trajton shndërrimin e lejes nga leje kërkim- zbulimi në leje shfrytëzimi.

Shkeljet ligjore të vëna në dukje nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar përmbushin kushtin për revokim të lejes nr.1696, datë 01.04.2014, sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur gërmën "ç" dhe "gj", të pikës 1, të nenit 47, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (neni që përcakton shkeljet ligjore kur një leje revokohet).

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar**

procedura e revokimit të lejes nr.1696, datë 01.04.2014, për mineral kromi, në objektin "Pishkash", Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan, që shoqëria e juaj zotëron.

Ju vëmë në dijeni se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare nr.1696, datë 01.04.2014, për mineral kromi, në objektin "Pishkash", Bashkia Prrenjas, Qarku Elbasan.

Në zbatim të nenit 13, pika 7, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, "Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e lejes së kërkim - zbulimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

ENIS ALIKO

